

TERMA REFERENCE (ToR)

Pozicioni: Psikolog

Qendra Sociale Multifunksionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara

Organizata: Shoqata “NdiHmoni Jetën”

Vendndodhja: Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj (me mundësi rinovimi)

Forma e punësimit: Me kohë të plotë

1. Hyrje – Qëllimi i shërbimit

Qendra Sociale Multifunksionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara, e administruar nga Shoqata “NdiHmoni Jetën”, ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të integruara sociale, dhe mbështetëse për persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe me çrregullim të spektrit të autizmit, si dhe për familjet dhe kujdestarët e tyre. Qendra synon të përmirësojë cilësinë e jetës së përfituesve, të rrisë pavarësinë, autonominë dhe aftësitë funksionale të tyre, si dhe të promovojë përfshirjen aktive sociale dhe komunitare, në përputhje me parimet e jetesës së pavarur, barazisë, mosdiskriminimit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

1. Përshkrimi i rolit

Psikologu është pjesë e ekipit multidisciplinar të Qendrës dhe ka rol kyç në vlerësimin, ndërhyrjen dhe mbështetjen psikologjike të fëmijëve dhe të rinjve përfitues, si dhe në fuqizimin psikosocial të familjeve dhe kujdestarëve të tyre. Roli i Psikologut konsiston në ofrimin e shërbimeve psikologjike individuale dhe në grup, hartimin dhe zbatimin e planeve individuale të ndërhyrjes, mbështetjen e zhvillimit emocional, social dhe sjellor të përfituesve, si dhe në kontributin për rritjen e autonomisë dhe aftësive të jetesës së pavarur dhe gjysmë të pavarur.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme

Punonjësi/ja do të:

- Kryejë vlerësime fillestare dhe periodike psikologjike për përfituesit e shërbimit;
- Hartojë dhe zbatojë plane individuale të ndërhyrjes psikologjike, në bashkëpunim me ekipin multidisciplinar;
- Ofrojnë seanca këshillimi dhe mbështetje psikologjike individuale dhe në grup për fëmijët dhe të rinjtë;
- Mbështesë menaxhimin e sjelljeve sfiduese dhe zhvillimin e aftësive emocionale e sociale;
- Kontribuojë në programet për jetesë të pavarur dhe gjysmë të pavarur për të rinjtë mbi 18 vjeç;
- Ofrojnë këshillim, orientim dhe mbështetje psikosociale për prindërit dhe kujdestarët;
- Bashkëpunojë ngushtë me profesionistët e tjerë të qendrës në planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve;
- Mbajë dokumentacion profesional dhe raporte periodike mbi ecurinë e përfituesve;
- Respektojnë etikën profesionale, konfidencialitetin dhe procedurat institucionale;
- Marrë pjesë në aktivitete trajnimi, supervizimi dhe zhvillimi profesional.

3. Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit

- Diplomë universitare në Psikologji (Bachelor dhe Master);



Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania
Mob:+355(0)682084945
E: info@helphthelife.org.al
W: www.helphthelife.org

- Licencë e vlefshme për ushtrimin e profesionit të Psikologut;
- Përvojë pune në shërbime për persona me aftësi të kufizuara dhe/ose çrregullim të spektrit të autizmit (e dëshirueshme);
- Njohuri mbi zhvillimin psikologjik, çrregullimet neurozhvillimore dhe ndërhyrjet psikosociale;
- Njohuri mbi standardet dhe legjislacionin për shërbimet sociale.

4. Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto Terma Reference, ftohen të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda afatit të përcaktuar, jo më vonë se data 30.01.2026, ora 17:00:

- Letër motivimi, ku të shpjegohet interesi për pozicionin dhe mënyra se si kandidati/ja i plotëson kriteret e kërkuara;
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar dhe e përditësuar;
- Kopje e diplomës Bachelor dhe/ose Master, sipas kërkesës së pozicionit;
- Kopje e licencës për ushtrimin e profesionit, sipas kërkesës së pozicionit;
- Dokumente të tjera mbështetëse (certifikata trajnimesh, referenca pune, etj.), nëse aplikohen.
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen në adresën e email: info@helphthelife.org.al me subjekt : Aplikim per pune (duke specifikuar pozicionin e dëshiruar).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për fazat e mëtejshme të procesit të përzgjedhjes.